**VENDIM**
**Nr.281, datë 9.5.2007**

**PËR KALIMIN E DIGËS SË LIQENIT ARTIFICIAL NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “k”, 5 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e digës së liqenit artificial në pronësi të Bashkisë së Tiranës, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## 3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME
### ( Te tipit te pronave qe inventariohen si klasa te veçanta )

Bashkia / institucioni qendror

Fusha e perdorimit te prones

Indentifikoi : (emri,mbiemri,pozicioni zyrtar

Supervizoi (emri,mbiemri,pozicioni zyrtar

Aprovoi (emri,mbiemri,pozicioni zyrtar

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Zona kadastr Indeksi hartes | nr. Pasurise | Emertesa e prones Vendndodhja/ Shtrirja Gjeografike | Komponentet perbereste prones | Adresae e komponenteve perberes | Permasat e Prones ne m2 ose ml | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni /En me pergjegjesi administrative | Institucioni/En perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (shenime te vecanta |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8280 | 1\3 | Liqeni artificial I Tiranes Ndodhet ne jug te qytetit te Tiranes | Diga e liqenit Kupa e rezervu-arit dhe element te tyre | Ne te njejtin vend ku ndodhet vepra | 377 000 m2 | Ambiental dhe per marrjen e ujit per qellime industriale | - | - | Diga e liqenit eshte riparuar pas defektit te vitit 1994 per te cilin kemi nje raport teknk ku kerkese per kete ka bere Bashkia e Tiranes |




BILANCI UJOR I LIQENIT ARTIFICIAL
PLANIMETRIA SH 1:10000
UJEMBLEDHESI SAUKUT
Sauku


TIRANES
FARKES
Farka e Madhe
Dep.Shër.Tokës dhe